39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-11220-5-2-1/C879

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj . Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitim të sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjatë koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve do të jetë për 399 ditë, brenda 24 muajve, sipas urdhërësës së menaxherit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 36 muaj .
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA
OBJEKTI I PENSIONISTËVE - P+1
LOKACIONI: GJAKOVË
INVESTITORI: KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
VËREJTJE: Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv. Per çdo ndryshim eventual te meret aprovim nga projektuesi. Ne te gjitha pozicionet perfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TE PERFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI.

1	PUNËT NDËRTIMORE				
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtes me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilot e hekurit dhe llamarina.	komplet	1.00	4,200.00 €	4,200.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1.00	850.00 €	850.00 €
1.01.03	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim	komplet	1.00	4,800.00 €	4,800.00 €
1.01.04	Pastrimi i tërësishëm i lokacionit ku do të ndertohet objekti, transporti i mbeturinave deri ne depони.	komplet	1.00	4,200.00 €	4,200.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.01					14,050.00 €

1.02	PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.02.01	Gërmimi i shtresës së humusit me trashësi 30 cm (kuota -0.65) në tërë sipërfaqen e parapare për pozicionimin e objektit, shtigjeve dhe pjesës së parkingut me rrugën e re. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m³	320.00	4.80 €	1,536.00 €



1.02.02	Gërmimi i dheut me makineri dhe dorë për hapjen e kanaleve për themelet shiritore të objektit. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkriftësisë.	m ³	192.50	4.80 €	924.00 €
1.02.03	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/31 për themelet shiritore në tërë gjerësinë e kanaleve të hapura duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=30 MPa. Vërejtje: Për shkak të mundësisë së humbjes së materialit në shtresën e dheut sasia e llogaritur është rritur për 50%	m ³	43.00	22.00 €	946.00 €
1.02.04	Furnizimi me material dhe mbushja e hapësirës përgjatë mureve të themeleve si dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/62 dhe 0/31 duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë MS=30 MPa. Vërejtje: Mbushja të realizohet pas betonimit të mureve të themeleve perimetrike deri në kuotën -0.30 për tërë gabaritin e objektit dhe pas veshjes së anës së brendshme me termoizolim XPS si në detal.	m ³	224.65	22.00 €	4,942.30 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.02					8,348.30 €

1.03	PUNËT E BETONIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
	VËREJTJE 1: Punëkryesi është i obliguar që të merr mostrat e betonit për çdo 'parti' betoni, të kujdeset për mirëmbajtjen e tyre, dërgimin në laboratore të specializuara për shqyrtimet e nevojshme dhe sigurimin e raporteve përkatëse për të gjitha mostrat. VËREJTJE 2: Për pozicionet e parapara të betonohen me shtesa të specifikuara si më poshtë punëkryesi obligohet që të veproj sipas udhëzimeve të prodhuesit duke ju përmbajtur reçetës së përzierjes, duke respektuar raportet e përzierjes ujë-çimento-agregat ndërsa aditivët e kërkuara duhet të shtohen në mikser pas ardhjes në punishte në praninë e organit mbikqyrës.				
1.03.01	Furnizimi me material dhe punimi i bazës për mbështetjen e elementeve të lidhura të armaturës së themeleve perimetrike. Betonimi të bëhet me beton të varfër të markës c-16/20 me trashësi min.5 cm mbi tamponin e zhavorit, duke përfshirë edhe nivelimin horizontal. Gjerësia e betonimit të jetë së paku nga 10 cm më e gjerë në të dy anët e shputës së themeleve.	m ³	6.80	110.00 €	748.00 €
1.03.02	Furnizimi me material dhe betonimi i shpates së themeleve shiritore me trashësi 60 cm dhe lartësi 50 cm, duke përfshirë dhe betonimin e murit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arrijtjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ²	96.60	120.00 €	11,592.00 €

1.03.03	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës në kuotën ± 0.00 . Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	92.70	120.00 €	11,124.00 €
1.03.04	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave të përdhësës dhe katit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	32.68	120.00 €	3,921.60 €
1.03.05	Furnizimi me material dhe betonimi i trajeve. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	36.47	110.00 €	4,011.70 €
1.03.06	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakave të meskatit, nenkulmit me trashësi 20 cm duke përfshirë edhe trarët perimetrik dhe konzollat në të gjitha anët. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	65.50	110.00 €	7,205.00 €
1.03.07	Furnizimi me material dhe betonimi i cerklazheve horizontale (trarët mbi dyer) me dimensione 12x20 cm dhe 25x20 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	6.80	110.00 €	748.00 €
1.03.08	Furnizimi me material dhe betonimi i shkallëve dhe rampës/pjerrinës tek tri hyrjet në objekt në nivelin e përdhësës. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Pozicionet të realizohen si elemente të mbështetura mbi tokë/zavor të pavarura nga themelet dhe coklla e objektit. Thellësia e fundimit -0.65. Në çmim të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ³	14.68	110.00 €	1,614.80 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.03					40,965.10 €

1.04	PUNËT E ARMIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
	Furnizimi me material, prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve të armaturës së brinjëzuar sipas planeve dhe specifikimeve të armaturës. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080 dhe duhet të jenë të pastra nga korrozioni. Në çmim të përfshihet përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.				
1.04.01	Armature fije dhe rrjeto sipas projektit	kg	38,864.25	1.34 €	52,078.10 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.04					52,078.10 €

1.05	PUNËT E MURATIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH

1.05.01	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25 me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMail" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m³	198.52	78.00 €	15,484.56 €
1.05.02	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 12 cm me blloqe të argjilës së pjekur, Giter G5 të lidhura me llaq të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMail" në raport 3:1. Fuga horizontale në mes të mureve dhe trarëve dhe pllakës të mbushet me shkumë montuese poliuretani për shtangim.	m³	38.65	45.00 €	1,739.25 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.05					17,223.81 €

1.06	PUNËT E SUVATIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.06.01	Furnizimi me material dhe suvatimi i plafoneve dhe suvatimi i sipërfaqeve të brendshme të mureve deri në nivelin e plafonit në të gjitha kthinat në përdheshë dhe nënkulm (përpos plafonet tek pjesa e nënkulmit, dhe hapsira ajorore nuk do të suvatohen) me material/llaq të parapërzler si RÖFIX 510 (gëlqere+cimento+agregat) ose me material të ngjashëm me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaq sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listellat metalike për caktimin e trashësisë së llaqit, këndoret metalike, listellat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rrjetë armimi dhe shirit votngjitës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdrukthtarisë me folle të PVC-së si dhe rrjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaqit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqe-beton.	m²	2,530.00	8.00 €	20,240.00 €
1.06.02	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve dhe plafoneve me dy shtresa glet-masë (secila me trashësi së paku 1 mm) RÖFIX 225 ose material të ngjashëm në të gjitha kthinat duke mos përfshirë muret e kthinave të cilat mveshen me pllaka.	m²	2,065.00	2.00 €	4,130.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.06					24,370.00 €

1.07	PUNËT E NGJYROSJES				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.07.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve dhe plafoneve me baze dhe dy shtresa ngjyrë StoColor In. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer për enterier si StoPrim Plex për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m²	2,065.00	1.20 €	2,478.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.07					2,478.00 €

1.08	PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESË
-------------	---

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.08.01	Furnizimi me material dhe shtrirja e pllakave termoizoluese me aftësi të madhe bartëse, rezistente ndaj lagështisë për pengimin e humbjeve të nxehtësisë përmes pllakës së dyshemesë në kontakt me dheun. Pllakat e tilla si Austrotherm XPS® 30 me trashësi 10 cm duhet të shtrohen mbi tamponin e zhavorit të ngjeshur brenda mureve të cokllës duke u niveluar me rërë të imët sipas nevojës. Njëherit shtresa e tillë shërben si bazament mbi të cilën vendosen armaturat e pllakës në nivelin e përdheshës.	m ²	489.00	3.20 €	1,564.80 €
1.08.02	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave termoizoluese me aftësi të madhe bartëse, rezistente ndaj lagështisë për pengimin e humbjeve të nxehtësisë përmes murit të themelit perimetrik. Pllakat e tilla si Austrotherm XPS® 30 me trashësi 8 cm duhet të ngjiten përgjatë dy anëve të themeleve perimetrike siç është paraqitur në detalin e themelit. Ngjitja bëhet me materialet e përshkruara në pozicionin e cokllës dekorative në pikën 1.12.02	m ²	194.50	2.00 €	389.00 €
1.08.03	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit në të gjitha kthinat e brendshme me dysheme nga pllakat qeramike duke përfshirë shtresën ndarëse nga folia adekuate e aluminit me veti të reflektimit të nxehtësisë për ngrohje në dysheme, shtresat termoizoluese dhe zëizoluese si dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi i nivelizimit me shtresat si në vijim: • Estrih me trashësi 5 cm • Folie/nënshtresë alumini për ngrohje gypore në dysheme • Austrotherm EPS® A100 termoizolim me trashësi 3 cm • Austrotherm EPS® T650 izolim akustik me trashësi 2 cm	m ²	642.50	8.00 €	5,140.00 €
1.08.04	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit dhe termoizolimit të nënkulmit mbi tërë sipërfaqen e pllakës së fundit duke përfshirë shtresat ndarëse nga foliet adekuate dhe shiritin perimetrik nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet realizimi i nivelizimit dhe termoizolimit me shtresat si në vijim: • Estrih me trashësi 5 cm • Folie PE • Austrotherm EPS® A120 termoizolim me trashësi 12 cm (6+6 cm për shmangien/mbulimin e fugave) • Rërë e imët për rrafshim/nivelim sipas nevojës	m ²	89.00	8.00 €	712.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.08					7,805.80 €

1.09	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH

1.9.01	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i nyjeve sanitare në përdhese duke përfshirë hidroizolimën e dyshemesë në këto kthinë si dhe hidroizolimën e mureve me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex të aplikuar në dy shtresa me trashësi nga 1 mm. Në pjesën e duheve të nyjet sanitare hidroizolimi të bëhet deri në 2 m lartësi. Në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të poliesterit ose rrjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasaritjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Gjatë aplikimit të materialeve të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe afatet e përcaktuara nga prodhuesi.	m ²	165.00	22.00 €	3,630.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.09					3,630.00 €

1.10	PUNËT E QERAMIKËS GRANITIT KUARCIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.10.01	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemesë në gjitha kthinat në përdhese dhe etazhe me pllaka të paglazura qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuar nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfituesit e objektit. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes të klasit min.R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuencën të madh me këpucë në ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 4 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	596.50	18.00 €	10,737.00 €
1.10.02	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve deri në lartësinë e plafonit tek nyjet sanitare, depo,kuzhine, zhveshtoret, hapsira teknike, wc per hendikep dhe wc-te, në përdhese dhe etazhe me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuara nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfituesit e objektit. Pllakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ²	565.00	18.00 €	10,170.00 €

1.10.03	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës me lartësi 10 cm tek hapësirat me mure të suvatuara si erembrojtësi, salla kryesore, holli hyres, koridoret, dhoma e mjekut, zyra e menaxherit, pjesa nën shkallë etj me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë dhe teksturë/dizajn të përcaktuara nga organi mbikqyrës në koordinim me shfrytëzuesit/përfituesit e objektit. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjitës kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM11 Plus me fuga të gjera 3 mm. Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40. Në çmim të përfshihen listellat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si Ceresit CS25.	m ¹	346.60	1.50 €	519.90 €
1.10.04	Furnizimi me material dhe mveshja e teraces me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhde të përpunuar me fiakë. Të gjitha sipërfaqet horizontale, vertikale dhe ato të pjerrëta të vishen me pllaka graniti me trashësi 2 cm duke përfshirë edhe pjesët anësore të shkallëve deri në kuotën -0.50 (së paku 20 cm nën nivelin e kubëzave) duke përfshirë cokllën me lartësi 10 cm në pjesët ku shkallët bashkohen me fasadën termoizoluese. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	29.70	48.00 €	1,425.60 €
1.10.05	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave të kuarcit për parapetin e të gjitha dritareve. Pllakat duhet të ngjiten me ngjitës adekuat për kuarc dhe në anën e poshtme duhet të kenë të gdhendura kanalet për pengimin e rrjedhjes së ujit në drejtim të murit. Parapeti të realizohet me 1 pllakë të vetme (pa vazhdime). Në çmim të përfshihet edhe mbyllja e fugave me shirita ekspandues hidroizolues dhe silikon sanitar. Trashësia 2 cm. Gjerësia 23 cm (së paku 2 cm duhet të dalin jashtë murit). Ngjyra e bardhë.	m ¹	58.50	20.00 €	1,170.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.10					24,022.50 €

1.11	PUNËT E ZDRUKTHTARISË DYERT DHE DRITARET				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH

1.11.01	Furnizimi dhe montimi i dyerve dhe dritareve të punuara nga profilet e aluminit sipas skemave dhe specifikimeve në projekt duke përfshirë të gjitha mjetet e lëvizjes dhe fiksimit dhe shkurshues montues nga PU. PRODHUESI ALUMIL ose prodhuos i cilësisë së njëjtë. SISTEMI SMARTIA M11000 profile alumini të ekstruduar me izolim termik 3 EPDM goma izoluese DRITARET Korniza fikse: M11010 62.5x58 mm ose M11014 62.5x68 cm opcionale Krahu i dritares: M11434 70.0x75 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90 mm Profili lëvizës T: M11058 Listella e kornizës: M11439 Listella e krahut: M15110 ELEMENTET PËRCJELLËSE TË DRITAREVE Mekanizmi: ROTO AL Mekanizëm për dritare alumini me hapje në aksin horizontal dhe vertikal Mënteshat: ROTO AL Ngjyra: Silver Anodised Dorëzat: ROTO Line Tipi me çelës: Lockable 100 Nm Ngjyra: Silver Anodised				
	DYERT tipologjia me hapje brenda Korniza fikse: M11086 67.7x68.0 mm Krahu i derës: M11082 62.5x90.4 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90.0 mm Profili lëvizës T: M11156 Parapeti i derës: M11142 Listella e kornizës: M11453 Listella e krahut: M11453 Pragu i ulët: M11184				
	DYERT tipologjia me hapje jashtë Korniza fikse: M11088 62.5x68.0 mm Krahu i derës: M11084 62.5x90.4 mm Profili i mesëm T: M11066 62.5x90.0 mm Profili lëvizës T: M11158 Parapeti i derës: M11142 Listella e kornizës: M11084 Listella e krahut: M11453 Pragu i ulët: M11184 ELEMENTET PËRCJELLËSE TË DYERVE Mekanizmi: ROTO SAFE HJH600 Bravë me mekanizëm për mbyllje mekanike shumëpikëshe Mënteshat: ROTO SOLID B Mëntesha dy pjesëshe Ngjyra: Silver Anodised 3 copë për krah Brava/Mbyllja: Euro cilindër mesingu me çelës Tipi me 6 gjilpëra Tipi : Anti Snap Dorëzat: Inox Tipi i levës me kapak në formë rozetash me profil për cilindër				
	KOMPONENTAT E PËRBASHKËTA Qelqi: Transparent Termopan 4+16+4mm/Low-E + Argon Paneli termoizolues: STADUR FB-4 Aluminium Sandwich element nga llamarinat e alumini me trashësi 1 mm me mbushje EPS t=24 mm E hirtë Anodised - RAL 7016 Ngjyra e profileve: E hirtë Anodised - RAL 7016 Izolimi akustik: 47 dB UF=2.3 W/m²K VËREJTJE: Të gjitha profilet e dyerve dhe dritareve pas montimit dhe ngurtësimit të shkurshues montues duhet tu largohen shiritat mbrojtës dhe të pastrohen nga pjesët ngjitëse sipas udhëzimeve të prodhuesit.				
a.	POS A-01 Derë dykrahëshe me mbidritë. Të gjitha mbushjet me qelq termopan. Dera duhet të ketë mbyllës hidraulik. Dimensionet: 305 x 290 cm Dukja si në skemën në Z.01	copë	2.00	1,200.00 €	2,400.00 €
b.	POS A-02 Derë dykrahëshe me mbidritë. Fusha e mbidritës me mbushje qelqi termopan. Dimensionet: 180x290 cm Dukja si në skemën në Z.02	copë	1.00	850.00 €	850.00 €
c.	POS A-03 Derë dykrahëshe me mbidritë. Fusha e mbidritës me mbushje qelqi termopan. Dimensionet: 165x290 cm Dukja si në skemën në Z.03	copë	2.00	800.00 €	1,600.00 €
d.	POS W01 Dritare dykrahëshe me hapje anësore dhe kiper. Dimensionet: 150x80 cm Dukja si në skemën në Z.04	copë	6.00	350.00 €	2,100.00 €

e.	POS W02 Dritare dykrahëshe me hapje anësore dhe kiper. Dimensionet: 260x290cm Dukja si në skemën në Z.05	copë	1.00	1,500.00 €	1,500.00 €
f.	POS W03 Dritare trikrahëshe me hapje anësore dhe kiper anash dhe pjesë të mesme fikse. Dimensionet: 300x80 cm Dukja si në skemën në Z.06	copë	1.00	500.00 €	500.00 €
g.	POS W04 Dritare dykrahëshe me hapje anësore dhe kiper. Dimensionet: 200x200 cm Dukja si në skemën në Z.07	copë	2.00	800.00 €	1,600.00 €
h.	POS W05 Dritare dykrahëshe me hapje anësore dhe kiper. Dimensionet: 155x260 cm Dukja si në skemën në Z.08	copë	1.00	850.00 €	850.00 €
i.	POS W06 Dritare njëkrahëshe statike në murin mes hapsires së stafit dhe salles kryesore. Dimensionet: 160x110 cm Dukja si në skemën në Z.09	copë	1.00	350.00 €	350.00 €
j.	POS W05 Dritare dykrahëshe me hapje anësore dhe kiper. Dimensionet: 200x220 cm Dukja si në skemën në Z.10	copë	3.00	600.00 €	1,800.00 €
1.11.02	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme për shumë qëllime. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: H3D Multi Purpose Door me mbushje nga leshi mineral - me trashësi 45 mm. Korniza e derës: dypjesëshe e kombinuar - nga korniza këndore me ankerë dhe dipla dhe kontra-kornizë Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak standard të zgjatur vertikal dhe profil për cilindër Mënteshat: 3 pjesësh për pesha të mëdha Ngjyra: E bardhë - RAL 9016. Mbyllësi hidraulik: Standard				
a.	POS D1 Derë e brendshme njëkrahëshe me mbindricim. Dimensionet: 90x260 cm. Dukja si në skemën e zdhukthtarise	copë	11.00	300.00 €	3,300.00 €
b.	POS D2 Derë e brendshme njëkrahëshe me mbindricim për persona me aftësi të kufizuara. Dimensionet: 100x260 cm. Dukja si në skemën e zdhukthtarise	copë	1.00	300.00 €	300.00 €
c.	POS D3 Derë e brendshme njëkrahëshe . Dimensionet: 80x205 cm. Dukja si në skemën e zdhukthtarise	copë	2.00	250.00 €	500.00 €
1.11.03	POS FS1 Furnizimi dhe montimi i fasades gjysemstrukturale anësore Profili ALUMIL - SOLAR M6 (me ndërprerje termike)apo të ngjajshme, Prodhuesi: ALUMIL Ngjyrë Antracid. XHAMI: Low-E (kater stinor)me veti të reflektimit të rrezeve të diellit, dhe me ruajtje të energjise së brendshme,te mbushura me Argon. Gjerësia e ramit dhe krahu i hapjes sipas specifikimit të zdhukthtarise. Dimensionet e fasades (katerkendeshe) jano 200 cm gjeresi dhe pika me e larte eshte 400 cm. Te ngjajshme jano 6 cope te tilla.	m ²	46.80	150.00 €	7,020.00 €

1.11.04	POS FS2 Furnizimi dhe montimi i fasades gjysemstrukturale anesore Profili ALUMIL - SOLAR M6 (me nderpreje termike)apo te ngjajshme, Prodhuesi: ALUMIL Ngjyre Antracid. XHAMI: Low-E (kater stinor)me veti te reflektimit te rrezeve te diellit, dhe me ruajte te energjise se brendshme,te mbushura me Argon. Gjerësia e ramit dhe krahu i hapjes sipas specifikimit të zdrukthtarisë. Dimensionet e fasades (pas kandeshe) jane 600 cm gjeresi dhe pika me e larte eshte 700 cm. Te ngjajshme jane 3 cope te tilla.	m ²	116.46	150.00 €	17,469.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.11					42,139.00 €

1.12	PUNËT E FASADËS				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.12.01	Furnizimi me material dhe punimi i fasadës së venteluar me tulla fasade me gjerësi 12 cm. Fasada e venteluar duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Termoizolim lesh guri t=8cm Lesh mineral fasade $\lambda_D = 0.035 \text{ W/mK}$ Fiksimi me anker metalik me rondelë plastike - 5 copë/m ² njëherit edhe për sigurimin e fasadës Vërejtje: Leshi mineral për shkak të mundësisë së kontaktit me lagështinë në pjesë të caktuara duhet të zëvendësohet me XPS 10 cm në lartësi 50 cm (1 pllakë). • Membranë difuzive LDS 0.04 FixPlus me shirit të integruar për ngjilje • Hapësirë ajrore min. 2 cm • Tulla fasade 12 cm - ngjyra të përcaktohet në konsultim me organin mbikqyrës të investitorit. Në fasadën e tullave duhet të lihen fuga të hapura në anën e poshtme dhe të opërme në raportin 75 cm ² për çdo 20 m ² të fasadës së venteluar. Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet e nevojshme për realizimin e pozicionit sipas standardeve.	m ²	479.40	32.00 €	15,340.80 €

1.12.02	Furnizimi me material dhe punimi i cokllës dekorative nga prodhimet e kompanisë Sto ose sistem tjetër të ngjashëm të prodhuesve tjerë. Coklla termoizoluese duhet të realizohet me shtresat si në vijim: • Lyerja bazë StoPrep Contact • Tiplla plastike • Ngjitës - masë hidroizoluese StoFlexyl • Termoizolim Austrotherm XPS 30 t=8 cm • Rrjetë Armimi - Sto-Glasfasergewebe • Dy shtresa masë armuese StoFlexyl • Lyerja bazë StoPutzgrund Nature • Llaç dekorativ shumëngjyrësh StoSuperlit K 2.0 mm Coklla duhet të realizohet nga kuota ±0.00 deri në kuotën -0.50 ose rreth 15 cm thellësi në nivelin e trotuarit të përfunduar për të shmangur ekspozimin nga ujët e mundshme të trotuarit. Në çmim duhet të përfshihen të gjitha elementet tjera të nevojshme si profilet bazë, profilet këndore me rrjetë, profilet e PVC -së me pikore, kunjat përforcues të plastikës, rondelat termoizoluese, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet fleksibël për fugat e dilatimit në fasadë, dhe materiale tjera sipas udhëzimeve të prodhuesit të sistemit termoizolues.	m ²	98.40	12.00 €	1,180.80 €
1.12.03	Furnizimi dhe montimi i pikoreve nga alumini si tipi Gutmann Fensterbank GS 40. Gjerësia e pikores duhet të jetë së paku 15 dhe është në varësi të trashësisë së shtresës termoizoluese ashtu që pikorja të jetë së paku 3 cm larg nga fasada. Materiali: Alumini i plastifikuar Ngjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt Në çmim të përfshihet edhe goma izoluese vetngjithëse EPDM UD40-25 për mbyllje të fugës mes pikores dhe profilin të dritarës.	m ^l	54.30	20.00 €	1,086.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.12					17,607.60 €

1.13	PUNËT ME PLLAKA GJIPSKARTONI				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.13.01	Furnizimi me material si dhe mbeshja e konstruksionit të kaminit. Mveshja duhet të bëhet me pllaka të forta të qëndrueshme ndaj lagështisë si Knauf AQUAPANEL® Cement Board Outdoor 12,5. Në çmim duhet të përfshihet edhe nënkonstruksioni metalik dhe të gjitha mjetet e nevojshme lidhëse.	m ²	45.00	16.00 €	720.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.13					720.00 €

1.14	PUNËT E KULMIT DHE LLAMARINËS				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH

1.14.01	Furnizimi dhe punimi i konstruksionit bartës dhe mbulesës së kulmit duke përfshirë, mbajtësit kryesor me dy breza të fartësive të ndryshme, brinjët (mahitë), dyshtemenë e punuar nga panelet OSB, membrana difuzive, mbulesa nga lamarina e rrafshët me lidhje vetklikuese falco, kapakët e kulmarëve, kapakët e lugjeve dhe gërmuqeve, ulluqet vertikale dhe horizontale, pikoret e mureve. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse si lamarina të perforuara, pllaka dhe këndore metalike për lidhjen e trarëve, bulonat ankerues për fiksion në pllakë, gozhda, vida dhe mjetet tjera të nevojshme. Kulmi i punuar ndahet në dy modele të ndryshme me shtresat si në vijim: A) KULMI TEK PJESA TEKNIKE / SANITARE - Lamarina montuese "Klikuese" - Folie difuzive - OSB Panel 18 mm - Folie difuzive - Termoizolim lësh guri t=12 cm 50 kg/m³ ~ i vendosur në mes konstruksionit të drurit 10x12 çdo 70 cm - Penda kundër avullit - Derrasa / Lamperi të perpunuara / Struguara - Konstruksioni mbjates (dru i lameluar) 10x20 cm B) KULMI TEK PJESA SALLES KRYESORE - Lamarina montuese "Klikuese" - Folie difuzive - OSB Panel 18 mm - Folie difuzive - Termoizolim lësh guri t=12 cm 50 kg/m³ ~ i vendosur në mes konstruksionit të drurit 10x12 çdo 70 cm - Penda kundër avullit - Derrasa / Lamperi të perpunuara / Struguara - Konstruksioni primar (dru i lameluar) 20x100 cm - Konstruksioni sekondar (dru i lameluar) 10x30 cm				
a.	KONSTRUKSIONI I KULMIT NËNKONSTRUKSIONI Trarë druri me dimensione të plota 8x12 cm për konstruksionin bartës të punuar si mbajtës me trarë horizontal në dy nivele dhe vertikale në distancë aksiale 70 cm. Lidhjet mes elementeve të bëhen me shirita të perforuar metalik, gozhda dhe vida të madhësive adekuate. Fiksion në pllakën e betonit me anker bulona në çdo 140 cm.	m ³	11.40	450.00 €	5,130.00 €
b.	KONSTRUKSIONI I KULMIT BRINJËT - A) KULMI TEK PJESA TEKNIKE / SANITARE Trarë druri i lameluar me dimensione të plota 10x20 cm për brinjët e pjerrëta të kulmit. Distanca aksiale në mes trarëve 70 cm. Lidhjet mes elementeve të bëhen me shirita të perforuar metalik, gozhda dhe vida të madhësive adekuate.	m ²	12.80	900.00 €	11,520.00 €
c.	KONSTRUKSIONI I KULMIT TRAJET KRYESORE - B) KULMI TEK PJESA SALLES KRYESORE Trarë druri i lameluar me dimensione të plota 20x100 cm për brinjët e pjerrëta të kulmit. Lidhjet mes elementeve të bëhen me shirita të perforuar metalik, gozhda dhe vida të madhësive adekuate.	m ³	12.85	900.00 €	11,565.00 €
d.	KONSTRUKSIONI I KULMIT TRAJET SEKONDARE - B) KULMI TEK PJESA SALLES KRYESORE Trarë druri i lameluar me dimensione të plota 30x10 cm për brinjët e pjerrëta të kulmit. Lidhjet mes elementeve të bëhen me shirita të perforuar metalik, gozhda dhe vida të madhësive adekuate.	m ³	16.74	900.00 €	15,066.00 €
h.	PANELE OSB 3 t=18 mm Panele me trashësi 18 mm për formimin e dyshtemesë së drurit mbi trarëzat/brinjët e kulmit. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksion në trarë/brinjët e drurit - vida/gozhdat në distancë adekuate dhe mjetet tjera të nevojshme sipas udhëzimeve të prodhuesit. Vërejtje: Vierat e logaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit.	m ²	562.50	15.00 €	8,437.50 €

i.	membranë difuzive 3 shtresore Ngjitja e membranës difuzive adekuate për kulm me mbulesë llamarine, rezistente ndaj temperaturave të larta, e ngjitur mbi dyshemenë nga panelet OSB. Materiali të shtrihet dhe fiksohet në dysheme sipas udhëzimeve të prodhuesit, ndërsa vazhdimet të realizohen me mbipalim të shtresës mbi shtresë për së paku 10 cm. Vijat e vazhdimëve të mbyllen me shirita vetëngjithës sipas specifikimeve të prodhuesit. Vërejtje: Vlerat e llogaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit. Në shifrën e dhënë të sipërfaqes për mbulim nuk është marrë në konsideratë mbipalimi i shtresave.	m ²	1,125.00	2.00 €	2,250.00 €
j.	Penda e kontrollit të avullit PP (Vapour Control Sheet PP) Ngjitja e membranës së kontrollit të avullit adekuate për kulm me mbulesë llamarine, rezistente ndaj temperaturave të larta, vendosur mbi dyshemenë me dërrasa të kulmit mbi të cilën do vendoset termoizolimi leshguri. Materiali të shtrihet dhe fiksohet në dysheme sipas udhëzimeve të prodhuesit, ndërsa vazhdimet të realizohen me mbipalim të shtresës mbi shtresë për së paku 10 cm. Vijat e vazhdimëve të mbyllen me shirita vetëngjithës sipas specifikimeve të prodhuesit. Vërejtje: Vlerat e llogaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit. Në shifrën e dhënë të sipërfaqes për mbulim nuk është marrë në konsideratë mbipalimi i shtresave.	m ²	562.50	4.00 €	2,250.00 €
k.	TERMOIZOLIM LESHGURI t=12 cm Termoizolim leshi guri për pjesën e nenkulmit t=12cm, $\lambda \leq 0.04W$, rezistenca në shtypje 50kg/m³ - Lesh Guri është material rezistent ndaj zjarrit, izolues ndaj nxehtësisë dhe izolues akustik i cili përmbanë 97% fibra natyrale që prodhohet nga shkrija e mineraleve dhe gurëve inorganik që rrjedhin nga shkëmbinjë vullkanik si bazalti, diabaz dhe dolomit midis 1400-1500 °C për të formuar fibra. Falë qëndrueshmërisë së tij dimensionale, leshi i gurit nuk ndikohet nga ndryshimet e temperaturës.	m ²	562.50	10.00 €	5,625.00 €
l.	LLAMARINA MONTUESE "KLIKUESE" Mbulimi i sipërfaqeve të pjerrëta të kulmit me llamarina të profiluara me gjerësi 475 mm (gjerësia mbuluese në varësi të brendit/prodhuesit) me brinjët e ngritura >30 mm për shtangim dhe montim/palim në njëra tjetrën me brezin e perforuar/vrima për vidat për fiksion në dërrasa. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksion në dysheme druri nga OSB panelet - vidat në çdo 30 cm dhe mjetet tjera të nevojshme. Vërejtje: Vlerat e llogaritura janë për sipërfaqen e pjerrët të kulmit duke llogaritur se mbulimi do të realizohet me elemente njëcopëshe. Në rast se mbulimi patjetër duhet të realizohet me vazhdimë atëherë duhet të ketë mbipalim të elementeve së paku 25 cm dhe radhitje të elementeve sipas udhëzimeve të prodhuesit. Vërejtje: Tipi i kërkuar i mbulesës mund të zëvendësohet eventualisht me llamarinë të rrafshët me lidhje falco klasike duke përmbushur të gjitha kushtet si për tipin e kërkuar, respektivisht të gjitha fiksionet dhe lidhjet të jenë në brendi të mbulesës ndërsa krijimi i lidhjeve falco të bëhet me anë të aparateve të posaçme.	m ²	562.50	15.00 €	8,437.50 €



m.	KAPAK PËR KULMARIN DHE GËRMUQAT Elemente nga llamarina e rrafshët e plastifikuar, të profiluara në formë "J" me gjerësi 25+25 cm për të gjitha pikëtakimet e rrafshëve të kulmeve e me mbyllje të plotë të hapësirës në mes të brinjëve të mbulesës duke e profiluar dhe përshtatur llamarinën në mes të brinjëve. Gjerësia e shpalosur e llamarinës 16 cm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksime - vidat ose "nitne" mbi çdo brinjë dhe në mes të fushës dhe mjetet tjera të nevojshme.	m ^l	128.00	8.00 €	1,024.00 €
n.	PIKORE LIDHËSE Elemente nga llamarina e rrafshët e plastifikuar, të profiluara në formë të shkronjës "h" për krijimin e lidhjes gjatësore në mes mbulesës së kulmit, dyshemesë nga OSB panelet dhe kanalit të ullukut të fshehur. Skajet e ekspozuara të elementit duhet të jenë të paluara dyfish për së paku 3 cm. Gjerësia e shpalosur e llamarinës për pikore 35 cm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse për fiksime në dysheme druri nga OSB panelet - vidat në çdo 30 cm dhe mjetet tjera të nevojshme.	m ^l	184.32	6.00 €	1,105.92 €
1.14.02	Furnizimi me material dhe punimi dhe montimi i elementeve të ndryshme nga llamarina e rrafshët e plastifikuar me trashësi 0.6 mm, me të gjitha elementet e nevojshme për sigurimin e padepërtueshmërisë së ujit si, pikore, hinka ujëmbledhëse, ulluqe horizontale dhe vertikale etj.				
a.	Ulluqe vertikale katrore 120x120 mm për të kulmin e pjerrët të punuara nga llamarina e rrafshët e plastifikuar me trashësi 0.6 mm me ngjyrë të hirtë duke përfshirë pjesët fazonike (kthesat), mbajtësit dhe elementet tjera të nevojshme për fiksime/ankerim. 10 copë	m ^l	46.00	8.00 €	368.00 €
b.	Ulluqe horizontale katrore 150x150 mm për të kulmin e pjerrët të punuara nga llamarina e rrafshët e plastifikuar me trashësi 0.6 mm me ngjyrë të hirtë duke përfshirë pjesët fazonike (kthesat), mbajtësit dhe elementet tjera të nevojshme për fiksime/ankerim.	m ^l	48.00	8.00 €	384.00 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 1.14					73,162.92 €



1.15	INVENTARI I OBJEKTIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.15.01	Furnizimi me material si dhe montimi i kaminit kualitativ me lënd djegëse drurin, me mvëshje metalike, i mbështjellur me tulla shamoti nga brenda, duke përfshirë të gjithë aksesoret e nevojshëm për funksionalizim të elementit. Dimensionet totale të kaminit të jenë 70x140x120 cm. Në çmim përfshihet montimi i xhamit dhe të gjitha pjesët metalike për funksionalizim të elementit.	copë	1.00	850.00 €	850.00 €
1.15.02	Furnizimi me material si dhe montimi i oxhakut të jashtëm me dimensione 50x120 cm i finalizuar me fasadë identike me pjesën tjetër të fasadës së objektit (me tulla), oxhaku të përbehet nga vrima me dimensione Ø 40 cm ndërsa pjesa tjetër të punohet me blloka në gjith gjatësinë e elementit. Në çmim janë të përfshira të gjithë elementet shtanguese, llamarinat, kapaket e të tjera.	m ^l	9.40	80.00 €	752.00 €



a.	Furnizimi me material si dhe mveshja e kaminit me gure dekorativ te ngjitura me ngjites adekuat, rezistent ndaj temperaturave te larta, ne cmim perfshihet dhe montimi i gureve te granitit per parapetet e kaminit. Ngjyra, dizajni dhe forma e mveshjes se kaminit percaktohet ne koordine me menaxherin e kontrates.	m ²	14.60	60.00 €	876.00 €
1.15.03	Furnizimi me elemente/njesi dhe montimi i inventarit dhe pajisjeve te kuzhinës për përgaditjen dhe ruajtjen e ushqimit, të gjitha të punuara nga llamarina e inoksit 304, për hapësirën kryesore të përgaditjes dhe hapësirën e larjes së enëve.				
a.	Frigorifer një derë me qelq Shifra: OR 07 TN Tipi: Monoblok Temperatura e ftohjes: +2/+10 °C Kapaciteti: 135 kg 1.23 m³ Fuqia: 352 W Dimensionet: 720x845x2060 mm	copë	1.00	550.00 €	550.00 €
b.	Frigorifer me dy dyer Shifra: OR 14 TN Tipi: Monoblok Temperatura e ftohjes: +2/+10 °C Kapaciteti: 190 kg 2.46 m³ Fuqia: 452 W Dimensionet: 1440x845x2060 mm	copë	1.00	550.00 €	550.00 €
c.	Shporet elektrik 4 pllaka pjesa poshtë: e hapur Shifra: ES08070 Tipi: Montona 700 Fuqia: 4x2.6 kW Dimensionet: 800x730x875 mm	copë	1.00	450.00 €	450.00 €
d.	Fritezë elektrike 2 vaska 13+13 litra pjesa poshtë: 2 dyer Shifra: EFD268070 Tipi: Montona 700 Fuqia: 24.0 kW Dimensionet: 800x730x875 mm	copë	1.00	450.00 €	450.00 €
e.	Skarë elektrike pillakë e rrafsh të kromi pjesa poshtë: e hapur Shifra: ER0KR4070 Tipi: Montona 700 Fuqia: 5.4 kW Dimensionet: 400x730x875 mm	copë	1.00	250.00 €	250.00 €
f.	Zierëse e pastave 2 vaska 28+28 litra pjesa poshtë: 2 dyer Shifra: EVT8070 Tipi: Montona 700 Fuqia: 11.0 kW Dimensionet: 800x730x875 mm	copë	1.00	250.00 €	250.00 €
g.	Vaskë e hapur për zierje 11 litra pjesa poshtë: 1 derë Shifra: EVT4070 Tipi: Montona 700 Fuqia: 4.5 kW Dimensionet: 400x730x875 mm	copë	1.00	250.00 €	250.00 €
h.	Vaskë e mbuluara për zierje GN 2/1 pjesa poshtë: e hapur Shifra: EVK08070 Tipi: Montona 700 Fuqia: 2.0 kW Dimensionet: 800x730x875 mm	copë	1.00	250.00 €	250.00 €
i.	Tavolinë pune me lavaman dhe bateri uji Pjesa e poshtme: rafta të hapur Dimensionet: 1500x700x875 mm	copë	1.00	350.00 €	350.00 €
j.	Tavolinë pune Pjesa e poshtme: rafta të hapur Dimensionet: 1500x700x875 mm	copë	1.00	350.00 €	350.00 €
k.	Tavolinë pune Pjesa e poshtme: rafta të hapur Dimensionet: 2200x700x875 mm	copë	1.00	350.00 €	350.00 €



l.	Furrë elektrike e kombinuar për pjekje me avull në 6 nivele Modeli: AOS061EBA2 ose model i ngjashëm Emri: ELECTRIC COMBI OVEN 6 GN 1/1 B LW Fuqia: 10.0 kW Dimensionet: 950x915x1060 mm	copë	1.00	1,050.00 €	1,050.00 €
m.	Bazament i hapur standard inoksi (për furrën me avull) Modeli: Standard open base with tray support for 6 and 10 GN 1/1 ovens Dimensionet: e përcaktuara sipas modelit	copë	1.00	250.00 €	250.00 €
n.	Furrë elektrike me konvektion për 4 tepsi Shifra: MINI 600-4M Kapaciteti: 4 tepsi 600x400 mm Fuqia: 3.7 kW Dimensionet: 750x648x495 mm	copë	1.00	650.00 €	650.00 €
4.04.01	_Njesia për përgaditjen e ajrit të ventilimit për montim në tavan, me 100% ajër të freskët dhe rekuperator pliakor, me këto njësi: _Ventilatori i prurjes V=5000 m³/h, Nel=0,5 kW , Dp = 200 Pa _Ventilatori i thithjes L=5000 m³/h, Nel=0,5 kW , Dp = 200 Pa	komplet	1.00	1,850.00 €	1,850.00 €
4.04.02	_Njesia për përgaditjen e ajrit të ventilimit për montim në tavan, me 100% ajër të freskët dhe rekuperator pliakor, me këto njësi: _Ventilatori i prurjes V=1000 m³/h, Nel=0,5 kW , Dp = 200 Pa _Ventilatori i thithjes L=1000 m³/h, Nel=0,5 kW , Dp = 200 Pa	komplet	2.00	850.00 €	1,700.00 €
4.04.03	_Punimi i kanaleve nga lëmarina e zinguar me trashësi 0.51.0 mm	kg	976.24	1.80 €	1,757.23 €
4.04.04	_Pjesët fazonike është 50% nga poz. paraprak	%	0.50	1,757.23 €	878.62 €
4.04.05	_Izolimi i kanaleve për prurjen e ajrit dhe kanalet me armaflex me trashësi 6 - 8 mm	m²	284.00	2.00 €	568.00 €
4.04.06	_Grilat fikëse kundër shiut, prodhues klima oprema ø450 mm ø250 mm	copë copë	2.00 2.00	100.00 € 100.00 €	200.00 € 200.00 €
4.04.07	_Furnizimi dhe montimi i grilave për prurje të ajrit me rregullim, një radhesh 425 x 225 mm, prodhues klima oprema	copë	12.00	30.00 €	360.00 €
4.04.08	_Furnizimi dhe montimi i grilave për thithje të ajrit me rregullim, një radhesh 625 x 225 mm, prodhues klima oprema	copë	6.00	60.00 €	360.00 €
4.04.09	_Furnizimi dhe montimi i grilave për prurje dhe thithje të ajrit me rregullim, një radhesh 425 x 225 mm, prodhues klima oprema	copë	10.00	40.00 €	400.00 €
4.04.10	_Furnizimi dhe montimi i grilave për prurje dhe thithje të ajrit me rregullim, një radhesh 425 x 125mm, prodhues klima oprema	copë	4.00	35.00 €	140.00 €
4.04.11	_Materjali shpenxues për montimin e kanaleve (shirit, silikon, etj)	komplet	1.00	40.00 €	40.00 €

4.04.12	Shqyrtimi i instalimit, testimi dhe leshimi ne pune	komplet	1.00	29.08 €	29.08 €
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 4.04					8,482.93 €

4.05	VENTILIMI I TOALETEVE				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
4.05.01	Ventilator TD 1000/150 prodhim S&P	copë	1.00	100.00 €	100.00
4.05.02	Ventilator TD 400/150 prodhim S&P	copë	1.00	100.00 €	100.00
4.05.03	PV valvola Ø125 mm	copë	14.00	10.00 €	140.00
4.05.04	Kanale trethore nga llamarinat	kg	248.00	4.00 €	992.00
4.05.05	Furnizimi dhe montimi i trakës antivibruese	m'	36.70	2.00 €	73.40
Gjithsej totali me TVSH - POZICIONI 4.05					1,405.40 €

REKAPITULLIMI		
4.01	PUNËT E NGROHJES NË DYSHEME	12,570.06 €
4.02	TRUPAT NGROHES- FTOHES DHE TUBACIONET	18,382.00 €
4.03	KTHINA TEKNIKE	8,660.00 €
4.04	VENTILIMI	8,482.93 €
4.05	VENTILIMI I TOALETEVE	1,405.40 €
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT E INSTALIMEVE TË MAKINERISË		49,480.39 €

REKAPITULLIM I TË GJITHA FAZAVE		
01	PUNËT NDËRTIMORE	375,734.73 €
02	PUNËT E INSTALIMIT ELEKTRIK	32,625.58 €
03	PUNËT E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	20,387.30 €
04	PUNËT E INSTALIMEVE TË MAKINERISË	49,480.39 €
Gjithsej totali me TVSH - OBJEKTI I PENSIONISTËVE - P+1		478,228.00 €

Vërejtje: Të gjitha materialet e përdorura duhet të jenë të klasit të parë, mostrat paraprakisht duhet të aprovohen nga organi mbikqyres. Në të gjitha pozicionet përfshihet furnizimi me material si dhe montimi i tij. Gjithashtu për punimin e çdo pozicioni duhet që mostrat të verifikohen në teren.



ANeks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikim teknik që favorizojnë ose disfavorizojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Për këtë projekt Autoriteti Kontraktues, njësia e kërkesës posedon komplet projektin, projekti mund të merret në drejtorinë për Shëndetësi.

Andaj Operatori Ekonomik duhet të përmbahen projektit detal dhe përshkrimit të Specifikimeve Teknike të këtij projekti.

PERSHKRIMI TEKNIK


LOKACIONI I OBJEKTIT TË PENSIONISTËVE

Lokacioni i parcelës së destinuar për këtë objekt respektivisht pjesa e ndarë në kuadër të parcelës më të madhe e cila përfshinë një zonë adekuate për funksionalizim të objektit për shtëpi të pensionistëve. Përparësi e lokacionit të përcaktuar nga investitori është se ka qasje të lehtë, e gjithë hapësira është hapësirë rekreative e mbuluar me gjelbrim të lartë dhe të ulët e cila ndikon pozitivisht në shëndetin e pensionistëve.

SITUACIONI I GJERË



SITUACIONI I NGUSHTË




POZICIONIMI I OBJEKTIT PËR PENSIONISTET

ARKITEKTURA DHE LIDHJET FUNKSIONALE TË OBJEKTIT

Objekti për pensionistet është projektuar si objekt me etazhitet P+1. Hyrja në objekt dhe në kompleks është e orientuar nga ana veriore. Në pjesën perëndimore të parcelës kemi parkingjet për personelin dhe vizitorët.

Objekti ngritet me një sistem skeletor të përbërë nga shtyllat e betonit të armuar, me pllaka masive meskati me trarë përderisa fondimi i objektit është paraparë të bëhet me themel pllakë me mur perimetrik – themel shiritor të futur thellësi nën nivelin e terrenit për mbrojtje të themelit pllakë nga ndikimet e ngricave. Mbyllja e objektit është paraparë të bëhet me blloqe argjile me gjerësi 25 cm ndërsa ndarjet e brendshme realizohen me blloqe argjile me gjerësi 25 cm dhe gjerësi 12 cm. Fasada është paraparë të realizohet si fasadë ventiluese termoizoluese e cila finalizohet me tulla.


FASADA JUG - LINDORE




FASADA VERI - LINDORE



FASADA VERI - PERENDIMORE



FASADA JUG - PERENDIMORE



FAZAT E KRYERJES SË PUNËVE

- 01 PUNËT PARAPREGADITORE
- 02 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT
- 03 PUNËT E BETONIT
- 04 PUNËT E ARMIMIT
- 05 PUNËT E MURATIMIT
- 06 PUNËT E SUVATIMIT
- 07 PUNËT E NGJYROSJES
- 08 PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESË
- 09 PUNËT E HIDROIZOLIMIT
- 10 PUNËT E QERAMIKËS | GRANITIT | KUARCIT
- 11 PUNËT E ZDRUKHTARISË | DYERT DHE DRITARET
- 12 PUNËT E FASADËS
- 13 PUNËT E KULMIT DHE LLAMARINËS

- 14 PUNËT E INVENTARI
- 15 PUNËT E NDRYSHME
- 16 PUNËT E INSTALIMEVE TË UJËSJELLËSIT & KANALIIMIT
- 17 PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE
- 18 PUNËT E INSTALIMEVE MAKINERIKE

VËREJTJE:

Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë shërbejnë si pikë referimi për cilësinë e kërkuar dhe si të tilla të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të cilat për nga karakteristikat janë të cilësisë së njëjtë ose edhe më të mira, gjë që duhet të dëshmohet me certifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit e tyre respektiv.

Në vazhdim do të elaborohen të gjitha punët veç e veç si dhe do të përshkruhen materialet që do të përdoren në çdo pozicion mirëpo për më shumë detale si dhe rreth karakteristikave të materialeve të propozuara në projekt duhet tu referoheni listave teknike dhe katalogjeve të materialeve të përshkruara, respektivisht udhëzimeve të prodhuesve respektiv.

01. PUNËT PARAPREGADITORE

Përfshijnë punët rreth pastrimit të parcelës nga të gjitha gjësendet dhe objektet që janë pengesë për mbarëvajtjen në mënyrë që të lirohet parcela e paraparë për qendrën e zjarrefikësve dhe më pas vazhdohet me rrethimin e punishtës, me shenjëzimin informativ si dhe me rregullimin e rrjetit të përkohshëm elektrik, ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe vendosjen e kontejnerit në punishtë. Lokacioni i tillë siç është me pjerrësi të vogël.

02. PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT

Në këtë fazë të punëve së pari kemi të bëjmë me largimin e humusit në thellësi prej 30 cm në tërë sipërfaqen ku do të ndërtohet objekti në fjalë, pastaj gërmimin e dheut për hapjen e gropës ndërtimore për themelin pllakë të objektit deri në kuotën e paraqitur si në pjesën grafike të projektit e më pas edhe hapjen dhe thellimin e kanaleve për muret perimetrike të fondimit. Pas gërmimit dhe nivelizimit të dheut duhet të bëhet ngjeshja e dheut me cilindër deri në arritjen e kompaktësisë së duhur të pasuar me shtrimin e zhavorit/gurit të thyer me fraksion 60/90 mm në një shtresë kompakte mbi të cilën më pas punohet tamponi nga betoni i varfër me trashësi 5 cm për shtrirjen e themelit pllake.

Më pas, vetëm pasi të jenë betonuar muret e themeleve perimetrike bëhet mbushja e hapësirës brenda këtyre themeleve perimetrike me zhavor/gur të thyer me fraksion 60/90 mm dhe kompaktësimin e tij në shtresa nga 20 cm deri në kuotat e paraqitura në pjesën grafike. Paraprakisht duhet të bëhet ngjitja e termoizolimit Austrotherm XPS 30 përgjatë mureve perimetrike në të katër anët 3 brendshme në të katër anët për të pakësuar dhe eliminuar urat termike në konstruksionin e betonit.

Pozicion tjetër i punëve është shtresa e zhavorit/gurit të thyer nën tërë sipërfaqen e objektit ku kemi shtrirjen dhe kompaktësimin e zhavorit/gurit të thyer me fraksion 0/31 me trashësi 25 cm mbi të cilën do të shtrihet termoizolimi Austrotherm XPS 30 i cili duhet të nivelizohet me ndihmën e rërës së imët sipas nevojës. Shtresa e

termoizolimit XPS shërben si bazament për vendosjen direkte të pllakës së dyshemesë.

03. PUNËT E BETONIT

Këtu kemi të bëjmë me betonimin e të gjitha elementeve duke filluar me betonimin e themeleve perimetrike shiritore, shtresën e betonit të varfër nën themel-pllake, betonimin e pllakës së dyshemesë së përdhësës, betonimin e pllakës së fundit, betonimin e shtyllave të betonit me dimensione të ndryshme, trarëve, shkallëve të jashtme dhe rampave/pjerrinave, strehëve, arkitrajeve mbi dyer e dritare, shtyllat dhe cerklazhet për shtangimin e mureve të atikës si dhe elemente tjera.

Themelet shiritore perimetrike janë me dimensione 100x40 cm.

Trarët në muret perimetrike do të jenë me gjerësi 25 cm përderisa të gjitha pllakat do të jenë me trashësi 20 cm ndërsa pllaka e dyshemesë së përdhësës 40cm.

Shtresat e betonit mbrojtës mbi zhavor nën themelet shiritore si dhe nën pjesët e pllakave mbi dhe do të punohen nga betoni i varfër i markës c-16/20 me trashësi 5 cm me qëllim të punës më të shpejtë e më të lehtë dhe për krijimin e bazamentit ku elementet e armaturës mund të pozicionohen më lehtë për krijimin e shtresës mbrojtëse pa u përzier me material që shkapërderdhet.

Të gjitha elementet konstruktive të betonarmesë duhet të realizohen nga betoni i markës c-25/30 përderisa disa nga elementet specifike nga betoni i armuar si pllakat e dyshemesë së përdhësës dhe muret e themeleve janë paraparë që të realizohen nga betoni me aditive për padepërtueshmërinë e ujit dhe më gjerësisht këto materiale do të elaborohen tek pjesa e punëve të hidroizolimit.

BETONI - Për klasën e kërkuar të betonit në rastet kur përdoret betoni i gatshëm duhet të kërkohet reçeta e përzierjes nga fabrika e betonit si dhe konsistenca e betonit sipas standardeve ISO-4109. Shqyrtimet e betonit duhet të bëhen duke marrë mostrat kubike me dimensione 20x20 cm nga betoni i freskët për çdo parti betonimi. Pas mirëmbajtjes adekuate ato duhet të testohen në laboratorët e autorizuar dhe licencuar. Pas ekzekutimit të punëve të konstruksionet e betonarmesë duhet të bëhet shqyrtimi i betonit me Sklerometër në prani të Organit Mbikqyrës.

VËREJTJE: Ekzekutuesi i punëve mund të fillojë me betonimin vetëm pasi të jetë bërë verifikimi i rezistencës së kallëpeve dhe formësimit dhe lidhjeve korrekte të elementeve të armaturës. Betoni duhet të vibrohet në mënyrë adekuate dhe të njëjtrajtshme në të gjitha pjesët sidomos kur kemi të bëjmë me pjesët që do të realizohen me aditive për papërshkueshmëri nga uji ndërsa për pjesët specifike si muret perimetrike dhe themel pllakën betonimi duhet të bëhet duke bërë përzierjen/shtimin e aditivëve në prani të organit mbikqyrës në punishte.

ÇIMENTOJA PC 45S - Për çimento nga duhet të kërkohet atestet nga prodhuesi si dhe të verifikohet afati i përdorimit dhe gjatë ndërtimit të verifikohet gjendja e çimentos kur të bëhet hapja e thasëve nëse vërehen shenja të lagështisë ose strukturës së kokërrizuar.

AGREGATI (ZHAVORRI) - Para prodhimit të betonit në punishte punëkryesi është i obliguar ti përmbahet reçetës së projektuar dhe për këtë duhet të sigurohet që përbërja granulometrike të jetë e sajuar nga tri apo më shumë fraksione agregati për një përbërje sa më optimale dhe njëherit të sigurohet se i tërë agregati do të jetë i pastërt nga lëndët organike dhe mbeturinat e dëmshme.

04. PUNËT E ARMIMIT

Punët e armaturës përfshijnë armimin e të gjitha elementeve konstruktive nga betoni i armuar. Në këto punë përfshihet prerja, lakimi, lidhja dhe formësimi i elementeve nga armatura të cilat janë specifikuar me paramasën dhe llogaritjen statike. Për këto punë është paraparë përdorimi i armaturave me diametër të ndryshëm të përcaktuara nga llogaria statike. Armatura e përdorur duhet të jetë e pastër nga korrozioni ndërsa për të siguruar mbrojtjen e saj edhe pas vënies në vepër duhet të përdoren elementet e gatshme nga PVC-ja - si distancerat e llojeve të ndryshme për tu siguruar për ekzekutimin e duhur të punëve dhe arritjen e trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.

Para se të vazhdohet me blerjen e armaturës paraprakisht duhet të kërkohen atestet nga prodhuesi dhe duhet të bëhet edhe verifikimi i trashësisë së shufrave respektivisht diametri i tyre dhe sipas nevojës edhe shqyrtimi i mostrave në laboratore adekuate. Të gjitha armaturat duhet të jenë të kualitetit B500B, sipas standardit EN-10080.

05. PUNËT E MURATIMIT

Të gjitha muret e jashtme dhe disa mure brendshme me trashësi 25 cm muratohen blloqe të argjilës së pjekur, Giter blloqe me dimensione 19x25x19 cm të muratuara me llaq të vazhduar të fituar nga përzierjen e rërës së imët me lëndë lidhëse të gatshme si "SharrMall" në raport 3:1 dhe ujë sipas nevojës. Pjesa tjetër e mureve ndarëse do të muratohen me Bllok12.




të
me
G5



06. PUNËT E SUVATIMIT

Në punët e suvatimit përfshihet suvatimi i mureve të brendshme me disa lloje materialesh varësisht nga destinimi i kthinës. Si pozicion më të madh kemi suvatimin e shtresës bazë me material të parapërzier të të gjitha mureve dhe plafoneve ku nuk do të ketë plafon të varur në këtë objekt.

Për këtë qëllim është paraparë përdorimi i materialit të gatshëm në thasë si RÖFIX 510 ose material të ngjashëm në përgjithësi me trashësi min.15 mm ndërsa tek kthinat që do të mvishen me qeramikë min.10 mm si në detalet e projektit.



Këtu duhet të përfshihet edhe përgaditja e bazës me llaç sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm, listellat metalike për caktimin e trashësisë së llaqit, këndoret metalike si dhe përdorimi i rjetave përforcuese nga fibrat e qelqit për parandalimin e plasaritjeve në çdo pjesë ku kemi kalim nga njëri material në tjetrin si nga sipërfaqja e muratuar në trarët/cerklazhët apo shtyllat nga betoni i armuar si dhe përforcimin e këndeve vertikale në mes të mureve.

Në një pjesë të madhe të objektit me përjashtim të nyjeve sanitare dhe hapësirës së garazhës dhe depove është paraparë që finalizimi i mureve të bëhet me dy shtresa glet-masë (secila me trashësi së paku 1 mm) si RÖFIX 225 ose material të ngjashëm. Të gjitha pozicionet e suvatimit dhe finalizimit duhet të realizohen në kushte optimale dhe në temperaturë jo më të ulët se $+5^{\circ}\text{C}$.

07. PUNËT E NGJYROSJES

Në kuadër të punëve të ngjyrosjes kemi ngjyrosjen e sipërfaqeve të enterierit. Për të gjitha kthinat në objektin e pensionistëve është paraparë të përdoret ngjyrë e cila i plotëson kushtet në disa aspekte si kërkesat mekanike me rezistencën ndaj abrazionit të lagësht të shkallës më të lartë, kërkesave kimike me rezistencën ndaj mjeteve dezinfektuese, thartirave dhe lëndëve tretëse, fizike me aftësinë për dekontaminim dhe sipërfaqe pa shkëlqim dhe kërkesat higjienike me aftësinë për tu pastruar edhe nga njollat më problematike duke mos e ngarkuar ajrin në kthinë. Një ngjyrë e kualitetit të tillë që plotëson të gjitha kërkesat është ngjyra me bazë poliuretani. Për hapësirat komunikuese si erëmbrojtësin, koridoret dhe deponë është paraparë të përdoret ngjyra e dedikuar për këto hapësira StoColor Puran.

Ngjyra në mure dhe plafone duhet të aplikohet në dy shtresa derisa të arrihet një pamje uniforme e sipërfaqes dhe pa njolla të dukshme.

Para aplikimit të ngjyrave të cekura më lart duhet të bëhet përgaditja e bazës - sipërfaqes së mureve me bazë/primer adekuat për enterier si StoPrim Plex që është një lëndë nga akrilati me bazë uji ose ndonjë tjetër lloj të përshtatshëm për hapësira të brendshme me qëllim të konsolidimit të bazës, për reduktimin e shkallës së apsorbimit të bazës, për të përmirësuar shkallën e ngjitjes etj.



08. PUNËT E TERMOIZOLIMIT, NIVELIZIMIT DHE VESHJEVE TË DYSHEMESË

Punët e termoizolimit përfshijnë izolimin e pjesëve të ndryshme si pllakën e përdhesës mbi dhe, pllakën e fundit dhe pjesën e hapësirës së nënkulmit

Për pllakën e përdhesës mbi dhe është paraparë shtrirja e pllakave termoizoluese me aftësi të madhe bartëse, rezistente ndaj lagështisë për pengimin e humbjeve të nxehtësisë përmes pllakës së dyshemesë në kontakt me dheun. Pllakat e tilla si Austrotherm XPS® 30 me trashësi 10 cm duhet të shtrohen mbi tamponin e zhavorit të ngjeshur brenda mureve të cokllës duke u niveluar me rërë të imët sipas nevojës. Njëherit shtresa e tillë shërben si bazament mbi të cilën vendosen armaturat e pllakës në nivelin e përdhesës.

Për pllakën e fundit është paraparë shtrirja e pllakave termoizoluese me aftësi të madhe bartëse si Austrotherm XPS® A120 me trashësi 12 cm të realizuar në dy shtresa me trashësi 6+6 cm me qëllim të mbulimit të fugave. Për realizimin e duhur mund të jetë i nevojshëm përdorimi i ngjitësit ose rërës së imët për të siguruar nivelimin e duhur. Mbi termoizolim aplikohet shtresa ndarëse – folie PE dhe estrih me trashësi 5 cm.

Pothuajse gjysma e sipërfaqes së shfrytëzueshme të objektit realizohet me punimin e dyshemesë së llojit "Ferobeton" duke aplikuar shtresa betoni me agregat kuarci dhe shtesa speciale për rritjen e fortësisë, rezistente ndaj abrazionit dhe goditjeve mekanike, me trashësi deri 10 cm me ramje drejt ujëmbledhësve, siç është masa e parapërgaditur Isomat Extra-Top ochre (ngjyrë dheu-oker) duke përfshirë edhe trajtimin e sipërfaqes me makinë me kokë rrotulluese për lëmim. Për të arritur lidhjen e duhur në mes të shtresës së Ferobetonit dhe pllakës së betonit të armuar duhet të bëhet trajtimi paraprak i pllakës me lëndë lidhëse si Adiplast, Durebond ose Ferroseal të prodhuesit Isomat. Sasia e aplikuar e materialit 3-5 kg/m².

Punët e nivelizimit përfshijnë nivelizimin e të pjesës më të madhe të hapësirave të brendshme me estrih me trashësi të ndryshme varësisht nga destinim i kthinës dhe materiali i përdorur për finalizimin e dyshemesë kështu që kemi disa lloje të nivelizimit. Në pjesën më të madhe të kthinave estrihu realizohet mbi folien e polietilenit (PE) si shtresë ndarëse pasi që të jenë shtruar dy shtresa të stiroporit me karakteristika të ndryshme.

Nivelizimi realizohet me shtresat si në vijim:

- Estrih me trashësi 4 cm
- Folie/nënshtresë alumini për ngrohje gypore në dysheme
- Austrotherm EPS® A100 | termoizolim me trashësi 3 cm
- Austrotherm EPS® T650 | izolim akustik me trashësi 2 cm

Shtresa e parë me trashësi 3 cm varësisht nga kthina përdoret për shkak të sigurimit të izolimit termik dhe për të mundësuar shtrirjen e kablove apo edhe tubave për instalimet e ndryshme ndërsa shtresa e dytë me trashësi 2 cm ndonëse kryen edhe funksionin e izolimit termik si qëllim primar ka izolimin akustik respektivisht mbrojtjen nga përcjellja e zërit struktural (goditës) ku për arritjen e plotë të këtij qëllimi duhet të përdoret edhe shiriti perimetrik nga polietileni (PE) me trashësi 5 mm i paraqitur si në detaje duke bërë edhe ndarjen fizike dhe pamundësimin e përcjelljes së zërit nga nivelizimi në muret kufizuese.

Sipërfaqet e betonit tek nivelizimet duhet të jenë plotësisht të rrafshta për të cilën duhet të përdoret pajisja e posaçme rrotulluese me të cilën bëhet lëmimi i sipërfaqes. Nivelizimi duhet të ekzekutohet me fuga dilatimi në çdo kalim nga njëra hapësirë në tjetrën dhe jo më larg se 6 m nga njëra tjetra.

09. PUNËT E HIDROIZOLIMIT

Punët e hidroizolimit në këtë objekt janë paraparë të realizohen në mënyrë jokonvencionale. Në vend se hidroizolimi të bëhet në mënyrë klasike me lëndë bituminoze ose membrana të përforcuara bituminoze që ngjiten me flakë ose në mënyra tjera në këtë objekt do të aplikohet betoni me shtesa/aditive të posaçme për joutjëlëshueshmëri të cilat përveç se e bëjnë betonin të papërshkueshëm nga uji ato lëndë mbesin aktive në mënyrë të përhershme dhe aktivizohen sapo të jenë në kontakt me ujin dhe njëherit mund të mbulojnë edhe të çarat/plasaritjet e imëta deri 0.4 mm të cilat paraqiten gjatë tharjes së betonit.



Një nga aditivët e tilla është aditivi kristalor si **Isomat Aquamat Admix** i cili mbetet aktiv përherë i cili përveç hidroizolimit të betonit pavarësisht se a kemi të bëjmë me presion pozitiv apo negativ të ujit ka edhe veti tjera pozitive si rritjen e rezistencës ndaj ngricave, mbrojtjen e armaturës nga korrozioni, zvogëlon ngritjen e ujit kapilar, nuk e dobëson markën e betonit dhe për më tepër është aditiv i aprovuar edhe për rezervoarë të ujit të pijshëm, pishina, tunele.

Ky aditiv në përgjithësi mund të përdoret si për konstruksione që janë në kontakt me ujin kohë pas kohe ashtu edhe për konstruksione që janë në kontakt të përhershëm me ujin. Sasia e rekomanduar e aditivit kristalor është 1 kg për 100 kg çimento:

Gjatë aplikimit të këtij aditivi duhet të zbatohen me përpikmëri të gjitha udhëzimet e prodhuesit në listat teknike rreth mënyrës dhe kohëzgjatjes së përzierjes me masën e betonit.

Betoni i përgaditur me këtë aditiv është paraparë të përdoret për betonimin e pllakës së dyshemesë së përdhësës në tërë objektin dhe për muret e themeleve për të parandaluar ngritjen e ujit kapilar.

Pozicion tjetër i punëve të hidroizolimit është hidroizolimi i nyjeve sanitare – toaleteve dhe dhomave të pastrimit. Për këtë është paraparë të përdoret hidroizolimi i lëngët si **Isomat Aquamat Flex** i përfshuar nga përzierja e dy komponentave të prodhimit me bazë të polimer çimentos të cilat paraqesin bazë të mirë për ngjitjen e materialeve tjera si për ngjitjen e pllakave të çeramikës, mermerit, granitit apo për muratim mbi bazën e trajtuar me këtë hidroizolim.

Kjo masë hidroizoluese duhet të aplikohet së paku në dy shtresa me trashësi jo më të madhe se 1 mm për të parandaluar plasaritjet. Komponenta A në formë pluhuri me peshë 25 kg përzihet me komponentën B, 8 kg lëng derisa të fitohet një masë viskoze e cila aplikohet mbi sipërfaqen e pastruar dhe të lagur të dyshemesë dhe mureve të suvatuara.



Për përforcimin e hidroizolimit në këndet në mes të mureve dhe dyshemesë duhet të përdoret shirita të gjerë 10 cm të pëlhurës së poliesterit (30 gr/m²) ose rrjetë përforcuese nga fibrat e qelqit (65 gr/m²) për të penguar plasaritjen e hidroizolimit.

Muret në nyjet sanitare duhet të izoloohen vertikalisht me këtë masë së paku deri në 30 cm lartësi. Para aplikimit të këtij materiali të gjitha zgavrat (boshllëqet) në beton duhet të mbushen dhe të rrafshohen me material që lidh shpejt ose llaç çimento të përforcuar me aditive pasi fillimisht janë larguar materialet mbushëse (çakëlli – zhavorri) të palidhura me sipërfaqen e betonit dhe është lagur me ujë sipërfaqja ndërsa nëse kemi fuga ekzistuese në dysHEME të betonit ato duhet të zgjerohen në formë V-je, përgjatë gjithë gjatësisë së tyre, në thellësi rreth 3 cm dhe mbushen me materialet e cekura si më lart.

Gjatë aplikimit të këtyre materialeve hidroizoluese duhet të respektohen me përpikmëri të gjitha udhëzimet e prodhuesit në listat teknike në të gjitha aspektet.

10. PUNËT E QERAMIKËS | GRANITIT | KUARCIT

Në këto punë përfshihen kryesisht punët e mveshjes së mureve dhe dyshemesë të gjitha këthinat e percaktuara sipas projektit me pllaka qeramike të klasit të parë me ngjyrë dhe dizajn sipas zgjedhjes së investitorit/organit mbikqyrës. Pllakat duhet të plotësojnë të gjitha kushtet në aspektin e saktësisë së dimensioneve, trashësisë, rrafshhtësisë së sipërfaqes dhe teheve, shkallës së përthithjes së lagështisë, fortësisë mekanike, rezistencës ndaj temperaturës dhe ngricave, rezistencën ndaj kemikaljeve dhe krijimit të njollave etj.

Për dysHEME duhet të përdoren pllaka të paglazuar me dimensione, ngjyrë dhe teksturë sipas përzgjedhjes së organit mbikqyrës në konsultim me palën që përfaqëson investitorin. Pllakat duhet të jenë rezistente ndaj rrëshqitjes min. R12, rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit dhe të përshtatshme për frekuentim të madh me këpucë në ambiente publike ku mund të ketë edhe një sasi të papastërtive që mund të shkaktojë gërvishje të sipërfaqes së tyre, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave duhet të bëhet me fuga të gjera 4 mm mbi bazamentin e thatë dhe të pastërt në të cilin paraprakisht është përfunduar hidroizolimi me materialet e cekura në pikat përkatëse.

Muret e nyjeve sanitare duhet të mvishen me pllaka të glazuara me dimensione, ngjyrë dhe teksturë sipas përzgjedhjes së organit mbikqyrës në konsultim me palën që përfaqëson investitorin. Pllakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave në mure duhet të bëhet me fuga të gjera 3 mm mbi bazamentin e thatë dhe të pastërt në të cilin paraprakisht është përfunduar hidroizolimi me materialet e cekura në pikat përkatëse deri në nivelin e plafonit.



Për ngjitje duhet të përdoret ngjitës adekuat për pllaka qeramike i cilësisë së lartë i cili duhet të jetë fleksibil dhe hidroizolues si **Ceresit CM 11 Plus** i përshtatshëm për përdorim në enterier dhe eksterier. Masa mbushëse për fuga duhet të jetë poashtu me karakteristika të tilla si fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si **Ceresit CE 40** e cila poashtu është e përshtatshme për përdorim në enterier dhe eksterier. Për të gjitha këndet e jashtme dhe cokllat e qeramikës duhet të përdoren listella këndore metalike/alumini me profil të rrumbullakësuar dhe ngjyrë që përshtatet me ngjyrën e fugës ndërsa për të gjitha këndet e brendshme (vijat vertikale) të formuara nga pllakat si dhe vija horizontale në mes të dyshemesë dhe mureve të mbushet me silikon sanitar rezistent ndaj mykut si **Ceresit CS 25**. Poashtu edhe vija kontaktuese në mes të pllakave dhe dritareve duhet të mbushet me silikon sanitar që të mos ketë kontakt të drejtpërdrejtë në mes të pllakave dhe kornizës së dritareve dhe të mos kemi përcjellje të vibrimeve nga korniza në pllakë.

MVESHJA ME PLLAKA KUARCI – Mveshje me kuarc kemi vetëm tek parapetet e dritareve.

Pllakat e parapetit në anën e brendshme duhet të kenë trashësi 2 cm dhe gjerësi min. 22 cm, me kanal të gdhendur në pjesën e poshtme, me skaje/tehe të lëmuara ose të rrumbullakësuar lehtë, të montuara me ngjitës adekuat për granit pa ramje. Pikoret duhet të dalin jashtë rrafshit të murit për së paku 2.5-3 cm. Në mes të pllakës dhe kornizës së dritares të përdoret shiriti ekspandues hidroizolues ndërsa pjesa e dukshme e fugës të mbushet me silikon sanitar me ngjyrë të kornizës së dritares. Këto pllaka duhet të ngjiten para se të bëhet finalizimi i mureve të brendshme me shtresën e fundit apo apo patinimi me glet-masë.

SHKALLËT E JASHTME - Shkallët e jashtme së bashku me rampën duhet të mvishen me pllaka graniti me teksturë të vrazhdë të parrëshqitshme, të përpunuar me flakë, të ngjitura me një shtresë llaçi të çimentosë së paku 2 cm të trashë drejtpërdrejtë mbi beton. Shkelëset e shkallëve dhe rampat punohen nga pllakat me trashësi 2 cm ashtu sikur edhe të gjitha pjesët tjera, si balloret dhe pushimoret mvishen me pllaka graniti me trashësi 2 cm.

MVESHJA E SHKALLËVE TË BRENDSHME - Është paraparë të bëhet me pllaka graniti të poliruar ku shkelëset duhet të jenë me trashësi së paku 3 cm ndërsa balloret nga pllakat me trashësi 2 cm të ngjitura me një shtresë llaçi të çimentosë së paku 1 cm të trashë drejtpërdrejtë mbi basamakët. Basamakët sipas nevojës duhet të nivelizohen paraprakisht. Gjerësia e pllakave për shkelëset e basamakëve tek të gjitha shkallët e brendshme duhet të jetë 32 cm ndërsa balloret punohen me lartësi 9.5 cm, Për të parandaluar njollosjen e mureve në kafazin e shkallëve duhet të punohen cokllat me lartësi min.10 cm nga pllakat e granitit me trashësi 2 cm në formë të kaskadave duke përcjellë formën e shkallëve dhe duke u lidhur edhe me cokllën e pushimoreve në tërë perimetrin e tyre.

11. PUNËT E ZDRUKHTARISË | DYERT DHE DRITARET

Këtu kemi të bëjmë me montimin e dyerve dhe dritareve sipas tipeve me specifikat e cekura në skemat e zdrukthtarisë dhe paramasë.

DRITARET DHE DYERT E JASHTME NGA ALUMINI - Punohen me porosi sipas skemave të zdrukthtarisë me profile alumini me ndërprerje të urës termike siç është profili i prodhuesit ALUMIL - Sistemi SMARTIA M11000, me gjerësi të kornizës 62.5 mm dhe krah me gjerësi 70 mm, ME 3 EPDM goma izoluese dhe sipërfaqe të rrafshta të profileve. Ngjyra e profileve: E hirtë – e anodizuar RAL 7016.

Për secilin pozicion me skemat e zdrukthtarisë është përcaktuar lloji i profileve për kornizën, për krahun e dritares/derës si dhe për profilet e mesme "I" apo edhe profilet për adaptimin e kahut të hapjes. Lloji dhe trashësia e qelqit realizohet si pako termopan me gjerësi 25 mm (4+16+4) me qelq të dyfishtë të tipit Low-E dhe hapësirë të mbushur me gas argoni. Dritaret duhet montohen në vend, të fiksohen së paku me nga 2 vidha në secilin profil dhe në distancë jo më të madhe 50 cm nga njëra tjetra ndërsa hapësira në mes të dritares dhe murit të mbushet me shkumë poliuretani. Mekanizmi për hapje me kiper duhet të jetë i tipit ROTO ose i ndonjë prodhuesi tjetër me cilësi të njëjtë. Të gjitha dritaret duhet të kenë nënshtresa çeliku dhe profile këndore nga PVC që të mundësohet montimi i elementeve tjera poshtë tyre si pikoret, parapeti etj.

Tipet e përvetësuara të profileve nga të cilat punohen dritaret dhe dyert e jashtme:

SMARTIA M11000 | profile alumini të ekstruduar me izolim termik | 3 EPDM goma izoluese

DRITARET

Korniza fikse: M11010 | 62.5x58 mm

Krahu i dritares: M11434 | 70.0x75 mm

Profili i mesëm T: M11066 | 62.5x90 mm

Profili lëvizës T: M11058

Listella e kornizës: M11439

Listella e kahut: M15110

ELEMENTET PËRCJELLËSE TË DRITAREVE

Mekanizmi: ROTO AL|Mekanizëm për dritare alumini|hapje e aksit horizontal/vertikal

Mënteshat: ROTO AL | Ngjyra: Silver Anodised

Dorezat: ROTO Line | Tipi me çelës: Lockable 100 Nm |Ngjyra: Silver Anodised

DYERT |Tipologjia me hapje brenda

Korniza fikse: M11086 | 67.7x68.0 mm

Krahu i derës: M11082 | 62.5x90.4 mm

Profili i mesëm T: M11066 | 62.5x90.0 mm

Profili lëvizës T: M11156

Parapeti i derës: M11142

Listella e kornizës: M11453

Listella e krahut: M11453

Pragu i ulët: M11184

DYERT |Tipologjia me hapje jashtë

Korniza fikse: M11088 | 62.5x68.0 mm

Krahu i derës: M11084 | 62.5x90.4 mm

Profili i mesëm T: M11066 | 62.5x90.0 mm

Profili lëvizës T: M11158

Parapeti i derës: M11142

Listella e kornizës: M11084

Listella e krahut: M11453

Pragu i ulët: M11184

ELEMENTET PËRCJELLËSE TË DYERVE

Mekanizmi: ROTO SAFE H|H600 | Bravë me mekanizëm për mbyllje mekanike shumëpikëshe

Mënteshat: ROTO SOLID B|Mëntesha dypjesëshe | Ngjyra: Silver Anodised | 3 copë për krah

Brava/Mbyllja: Euro cilindër mesingu me çelës | Tipi me 6 gjilpëra |Tipi: Anti Snap

Dorëzat: Inox | Tipi i levës me kapak në formë rozetash me profil për cilindër

KOMPONENTAT E PËRBASHKËTA

Qelqi: Transparent | Termopan | 4+16+4mm/Low-E + Argon

Paneli termoizolues: STADUR FB-4 Aluminium | Sandwich element nga llamarinat e alumini me trashësi 1 mm me mbushje EPS t=24 mm E hirtë | Anodised - RAL 7016

Ngjyra e profileve: E hirtë | Anodised - RAL 7016

Izolimi akustik: 47 dB

UF=2.3 W/m²K

DYERT E BRENDSHME – duhet të punohen nga profilet e aluminit sipas skemave dhe specifikimeve në projekt duke përfshirë të gjitha mjetet e lidhjes dhe fiksimit dhe shkumën montuese nga PU.

PRODHUESI | ALUMIL ose prodhues i cilësisë së njëjtë.

SMARTIA M15000 profile alumini pa izolim termnik |3 EPDM goma izoluese

Korniza fikse: M15012 | 50x 68 mm
 Krah i derës: M15182 | 50x105 mm | hapja brenda
 Krah i derës: M15076 | 50x105 mm | hapja jashtë
 Profili i mesëm T: M15062 | 50x 80 mm
 Parapeti i dyerve: M15142 | 50x150 mm
 Profili lëviz T: M15191
 Listella e kornizës: M11451
 Listella e krahut: M11451
 Pragu i ulët: M15195

ELEMENTET PËRCJELLËSE TË DYERVE

Mekanizmi: ROTO SAFE H/H600 AL
 Bravë me mekanizëm për mbyllje mekanike shumëpikëshe
 Mënteshat: ROTO SOLID B/I30 R | Mëntesha dypjesëshe
 Ngjyra: Silver Anodised | 3 copë për krah
 Brava/Mbyllja: Euro cilindër mesingu me çelës | Tipi me 6 gjilpëra | Tipi : Anti Snap
 Dorëzat: Inox | Tipi i levës me kapak në formë rozetash me profil për cilindër
 Ngjyra e profileve: E hirtë | Anodised - RAL 7016

KOMPONENTAT E PËRBASHKËTA

Qelqi: Transparent | Termopan | 4+16+4mm/Low-E + Argon
 Paneli termoizolues: STADUR FB-4 Aluminium | Sandwich element nga llamarinat e alumini me trashësi 1 mm me mbushje EPS t=24 mm E hirtë | Anodised - RAL 7016
 Ngjyra e profileve: E hirtë | Anodised - RAL 7016

VËREJTJE: Të gjitha profileve të dyerve dhe dritareve pas montimit dhe ngurtësimit të shkumës montuese duhet tu largohen shiritat mbrojtës dhe të pastrohen nga pjesët ngjitëse sipas udhëzimeve të prodhuesit.


12. PUNËT E FASADËS

Fasada e objektit është paraparë të realizohet si fasadë termoizoluese e cila do të finalizohet me llaç struktural ndërsa vetëm në pjesë të caktuara coklla do të finalizohen me llaç dekorativ nga gurët shumëngjyrësh.

FASADA VENTILUESE ME TULLA


me llaç struktural realizohet me shtresat si në vijim:

1. Ngjitës - StoLevell Uni
2. Termoizolim – Lesh guri 120kg/m³ - t=10 cm e perforuar
me kunjat adekuat 5-6 cope per m²
3. Folie difuzive
4. Hapsire ajrore
5. Konstruksioni mbajtes
6. Tulla me dimensione 12x6.5x25 cm




Coklla termoizoluese e finalizuar me llaç dekorativ shumëngjyrës 2.0 mm realizohet me shtresat si në vijim:

1. Lyerja bazë
2. Ngjitës - masë hidroizoluese
3. Austrotherm XPS® 30 - t=8 cm
4. Rrjetë armimi dhe dy shtresa
masë hidroizoluese
5. Lyerja bazë
6. Llaç dekorativ shumëngjyrësh K 2.0 mm




Coklla termoizoluese duhet të punohet deri në nivelin e përcaktuar me detalet e projektit, deri në nivelin e platosë dhe shtigjeve në mënyrë që edhe nëse trotuari pëson ulje coklla të duket e kompletuar dhe jo e zhveshur nga shtresa finale.

Për ekzekutim të suksesshëm të të gjitha pozicioneve të fasadës termoizoluese të cekura më lart të duhet të përdoren të gjitha elementet e rekomanduara nga prodhuesi i sistemit të fasadës termoizoluese si, profili bazë metalik në tërë perimetrin e objektit, profilet këndore me rrjetë për mbrojtjen e këndeve, profilet e PVC për pikore, kunjat e plastikës për montim të sigurtë të stiroporit sipas udhëzimeve të prodhuesit, rondelat termoizoluese për mbulimin e rozetave të kunjave (tiplave), listellat dilatuese nga plastika me rrjetë armimi dhe shirit vetngjitës për dyer dhe dritare, shiritat ekspandues hidroizolues, profilet konzollë me ndërprerje termike për mbështetjen e pllakave të granitit për pikoret e dritareve dhe kornizave rreth dritareve, profilet fleksibile me rrjetë për fugat e dilatimit në fasadë, shkuma e poliuretanit për mbushjen e hapësirave që arrihen vështirë, armimi diagonal me rrjetë i këndeve të dritareve, mënyra e ngjitjes në mur respektivisht forma dhe sasia e ngjitësit të përdorur, mënyra dhe numri i kunjave/tiplave të përdorur etj.



13. PUNËT E KULMIT DHE LLAMARINËS

Objekti mbulohet me kulm të pjerrët katërujor me pjerrësi prej 8° i finalizuar me llamarinë të rrafshët me lidhje të tipit falco me vetklikim. Fiksimi i tyre bëhet sipas udhëzimeve mbi dyshemënë e dërrasave dhe si të specifikuara në prerjet dhe detalet e projektit me të gjitha elementet e nevojshme lidhëse sipas udhëzimeve të prodhuesit. Nën llamarinën e rrafshët shtrohet membrana difuzive trishtresore mbi dyshemë e krijuar nga panelet e tipit OSB 3.




KULMET NE OBJEKTIN E PENSIONISTAVE REALIZOHEN NE DY FORMA:

Forma e pare tek pjesa teknike realizohet sipas detalit 1.


Fillimisht behet pozicionimi i trajve te drurit te lameluar me dimensione 10x20 cm ne distance aksiale nga njeri tjetri cdo 70 cm, pastaj behet mbulimi i tyre nga ana e sipërme me derrasa (lamperi) decorative te perpunuar me trashesi 2 cm, e cila mbulohet me folie (penden) e avullit, e cila vendoset nen termoizolimimin lesh guri me trashesi 12 cm me peshe minimale 70 kg/m³, ku ne mes cdo hapsire te termoizolimit vendosen trajet e drurit 8x12 cm te cilet sherbejne per perforcimin e OSB paneleve me trashesi 1.8 cm. Mbi OSB panelet vendoset folia difuzive e cila mbulohet me llamarinen me falc.

Te gjithë materialet e pershkruara vendosen sipas pershkrimit specifik te prodhuesit.



Forma e dyte tek pjesa e salles kryesore realizohet sipas detalit 2.

Pas pozicionimit te trajeve kryesore te drurit te lameluar me dimensione 30x100 cm, lidhjes mes vete dhe mbeshtetjes me pllaka metalike kualitative adekuate per secilin pozicion, behet vendosja e trajeve te konstruksionit sekondar nga druri I lameluar me dimensione 10x30 cm, tra I cili vendoset ne forme te kryqezuar ne piken me te larte te kulmit. Lidhja mes trajeve primare dhe sekondare behet me brinjet nga druri I lameluar me dimensione 10x20 cm ne distance aksiale cdo 70 cm ne te gjitha drejtimet, pastaj behet mbulimi I tyre nga ana e sipërme me derrasa (lamperi) decorative te perpunuar me trashesi 2 cm, e cila mbulohet me folie (penden) e avullit, e cila vendoset nen termoizolimin lesh guri me trashesi 12 cm me peshe minimale 70 kg/m³, ku ne mes cdo hapsire te termoizolimit vendosen trajet e drurit 8x12 cm te cilet sherbejne per perforcimin e OSB paneleve me trashesi 1.8 cm. Mbi OSB panelet vendoset folia difuzive e cila mbulohet me llamarinen me falc.



15. PUNËT E INVENTARIT

Te behet furnizimi dhe montimi I te gjitha paisjeve ne koordinim me menaxherin e kontrates duke u bazuar ne pergjedhjen e ngjyres dhe pozicionimit te elementeve. Montimin dhe funksionalimin e kuzhines gjer ne funksionalizim te plote te elementeve.

16. PUNËT E NDRYSHME

KUBËZAT E BETONIT - Pozicioni kryesor është shtrimi i rrugëve rreth objektit dhe pjesëve të përcaktuara si në projekt me kubëza betoni të presuar me vibrim me trashësi 8 cm. Për rregullimin e bazamentit mbi të cilin shtrohen kubëzat duhet të aplikohen shtresat sipas rekomandimeve të prodhuesve varësisht nga destinimi i sipërfaqeve të cilat janë përcaktuar edhe në projekt. Meqenëse në këtë rast kemi kryesisht shtigje dhe plato për këmbësor nga prodhuesit rekomandohet që pas ngjeshjes adekuatë të bazës së pari të shtrohet një shtresë e rërës së imët me trashësi 20 cm, mbi të një shtresë me trashësi 10 cm e zhavorit 0/31 dhe një shtresë me trashësi 5 cm e zhavorit 4/8 mm mbi të cilën shtrohen më pas kubëzat e betonit.



Prishtinë /10.11.2023

Aneksi - 6.1

AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE

Për: KOMUNA E GJAKOVËS
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Ndërtimi i shtëpisë së të moshuarve në Gjakovë

Numri i Prokurimit: 632-23-11220-5-2-1

Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Afatin e Implementimit të projektit dhe Periudhën Garantuese

DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriter i dhënies është Tenderit Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për PERIUDHËN GARANTUESE dhe AFATIN E IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTI, DEKLAROJMË se do të përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për një periudhat e përcaktuara si më poshtë:

I. AFATI I IMPLEMENTIMIT të këtij projekti është 399 ditë, nga
(Shëno numrin e ditëve)
data e fillimit të punëve e përcaktuar nga Menaxheri i Kontratës.

II. PERIUDHA GARANTUESE vlen 3 vite nga data e pranimit
(Shëno numrin e viteve)

të përkohshëm të projektit nga Autoriteti Kontraktues, për projektin e cekur në këtë deklaratë.

Basret Selimi

Emri i përfaqësuesit të OE

Basret Selimi
Nënshkrimi





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 12187344

Për KOMUNA E GJAKOVES

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të AIPING SH.P.K.

(emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndërtimi i shtëpisë së të moshuarve në Gjakovë**

Nr. prokurimit: 632-23-11220-5-2-1, Nr. brendshëm: ...

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t' i japim tenderuesit këtë garanci. Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **47,822.80€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **47,822.80€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 761 ditë kalendarike prej **10.01.2024** deri më **09.02.2026**

Data lëshimit: 10.01.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për dështimin (UNIG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.




PJESA V E KONTRATËS:**IDENTIFIKIMI FINANCIAR**

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	ALPING SHPK
Adresa	Biloku 6, Objekti II, Kafabri, PN
Qyteti	Prishtine
Kodi Postar	10000
Kontakti	Basret Selimi
Telefoni	044358254
Fax	/
E-mail	alping.shpk@gmail.com
Numri i TVSH	330418518

BANKA	
Emri	Procredit Bank Sha
Adresa	Str. George Bush no.26
Qyteti	Prishtine
Kodi Postar	10000
Shteti	Kosove
Llogaria Bankare	1189007835000121
IBAN (opcionale)	KX051189007835000121
BIC (Opcionale)	MBKOKPR

SHËNIME:

**VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I
PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të
dyja të obligueshme)**



**DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT
TË LLOGARISË: (e obligueshme)**

09.01.2024

